

Udhëzim për udhëheqjen e Evidencës pedagogjike për mësimin shtues

Në pajtim me nenin 32 të Ligjit për arsim fillor, orët shtuese organizohen për nxënësit të cilët arrijnë rezultate të konsiderueshme në lëndë të caktuara mësimore. Mësimdhënësi planifikon mësimin shtues në përputhje me nevojat e nxënësve, ai detyrohet t’ju ofrojë nxënësve, ndërsa nxënësit vendosin se a do ta ndjekin mësimin shtues.

Evidenca pedagogjike për mësimin shtues, si formular për dokumentacionin dhe evidencën pedagogjike në shkollat fillore është vendosur në ueb faqen e Byrosë së Zhvillimit të Arsimit (www.bro.gov.mk), Veprimtaria botuese, Dokumentacioni dhe evidenca pedagogjike) si Word dokument. Mësimdhënësi klasor ose lëndor **Evidencën pedagogjike për mësimin shtues** (formularin numër 17) e udhëheq në mënyrë elektronike gjatë tërë viti shkollor.

Mësimdhënësi fillimisht e plotëson faqen e kopërtinës të formularit, **Të dhënat pedagogjike për mësimin shtues** (e shënon emrin e shkollës fillore, vendin dhe komunën në të cilën ndodhet shkolla, vitin shkollor për të cilin mbahen **Evidencë pedagogjike për orët shtuese**, shënon emrin dhe mbiemrin e tij dhe shënon datën kur filloi të plotësojë dokumentin. Në faqen e 1 mësimdhënësi e shënon periudhën kohore gjatë vitit shkollor gjatë të cilit duhet realizuar mësimi shtues, si dhe numrin e orëve të planifikuara gjatë një jave. Nëse ka nevojë, varësisht nga mbikëqyrjet e mësimdhënësit me kërkesë të nxënësit/nxënësës ose kërkesë të prindit/tutorit, mësimdhënësi gjatë vitit shkollor mund të planifikojë dhe realizojë disa herë mësimin shtues (për shembull, mësimdhënësi lëndor i gjuhës maqedonishte në një periudhë kohore do të planifikojë dhe realizojë mësimin shtues për nxënësit nga 6-a, 6-b, në periudhë tjetër kohore për nxënësit e klasave 8-a dhe 8-b, në periudhë tjetër kohore për nxënësit 9 - c etj.). Në këtë rast mësimdhënësi në dokumentin në faqen 1 në kolonën *Periudha kohore* dhe *Numri i orëve të planifikuara në javë* shënon të dhënat për mësimin e dytë, të tretë .. të planifikuar shtues në një periudhë tjetër kohore (për shembull mësimi shtues për nxënësit nga klasat 6 – a dhe 6 - b, në një periudhë tjetër kohore për nxënësit nga klasa 8 – ç dhe 8 - b, etj.). Në kolonat e *parapara dita/ditët e javës* dhe *koha gjatë javës* mësimdhënësi i vendos të dhënat adekuate për secilin mësim të planifikuar shtues.

Në kuadër *Të dhënave themelore për mësimin shtues*, mësimdhënësi vendos: lëndën për të cilën është planifikuar mësimi shtues; numrin e planifikuar të nxënësve; periudhën kohore; qëllimin e përgjithshëm; rezultatet nga mësimi që duhet të arrihen në

kuadër të mësimit shtues; mënyrën e realizimit, mënyrën e vlerësimit; mënyrën e përdorimit të secilit mësimit të planifikuar shtues.

Në seksionin *Plani vjetor dhe programi i mësimit shtues* në kolonën numri rendor theksohet me numrin 1 në mësimin e parë shtues të planifikuar, rezultatet që do të arrihen me nxënësit brenda atyre orëve shtuese, numri i orëve të planifikuara, data/datat për realizim, si dhe emrin, mbiemrin dhe në cilën klasë regjistrohen nxënësit që duhet të ndjekin atë orë shtuese. Nën numrin rendor 2, 3 .. futen të dhënat për mësimin e dytë, të tretë ... shtues që planifikohen deri në fund të vitit shkollor.

Në kuadër të *Evidencës së orëve të realizuara të mësimit shtues* vendosen të dhënat për secilën orë të realizuar të mësimit shtues, pas përfundimit të asaj ore dhe: numri rendor i orës, data e realizimit, përmbajtja e orës së mësimit shtues dhe vërejtje (nëse ka nevojë). Nëse realizohet mësimi i dytë shtues, për mësimin e parë shtues me **numër rendor** evidentohen orët e realizuara si 1.1, 1.2, 1.3..., deri në orën e fundit, ndërsa për mësimin e dytë shtues evidentohen orët e realizuara si këto 2.1, 2.2, 2.3, 2.4..... deri në orën e fundit.

Në pjesën *Lista e nxënësve të përfshirë në aktivitetin shtues dhe rishikimin e rregullsisë së tyre*, shkruhet numri rendor i nxënësit, emri e mbiemri i nxënësit që duhet të përfshihet në arsimin shtues konkret, në të cilën paralele është regjistruar ai/ajo nxënës/nxënëse, në cilën datë nxënësi/nxënësja nuk ishte i pranishëm dhe sa mungesa ka secili nxënës në fund të mësimit shtues.

Në pjesën *Përcjellja dhe vlerësimi i arritjeve të nxënësit/nxënëses* në mësimin shtues vendoset në fund të mësimit shtues, numri rendor i njëjtë i nxënësit/nxënëses nga pjesa *Listat e nxënësve të inkuadruar në aktivitetin shtues dhe pasqyra e rregullsisë së tyre*, emri e mbiemri i nxënësit/nxënëses i cili/e cila ka qenë i/e inkuadruar në mësimin konkret shtues, në cilën paralele është regjistruar ai/ajo nxënës/nxënëse, ndërsa në kolonën SHËNIME mësimitdhënësi i vendos rezultatet e përcjelljes dhe vlerësimit të arritjeve të secilit nxënës në mësimin shtues (sa janë arrit rezultatet nga mësimi shtues, nëse nuk kanë arrit rezultate vallë është e nevojshme të vazhdohet me mësimin shtues etj). Mësimitdhënësi duhet detyrimisht t'i informojë prindërit/tutorët e nxënësit/nxënëset për rezultatet e tyre të arritura dhe për rekomandimin eventual për nevojën e mëtejshme të mësimit shtues.

Pjesa *Analiza e suksesit të mësimit shtues* plotësohet në fund të vitit shkollor, ku për secilën mësimitdhënësi të realizuar shtesë vendoset në përgjithësi: cilat janë

konkluzionet, sa me sukses janë realizuar qëllimet e përcaktuara, si dhe propozimet e mundshme për përmirësimin e planifikimit dhe realizimit të mësimit shtues. Teksti nga *Analiza e suksesit të mësimit shtues*, dhe të dhënat statistikore për mësimin shtues (sa nxënës gjithsej morën pjesë në secilin mësim shtues, çfarë është realizuar nga Plani vjetor dhe programi i mësimit shtuese, dhe çfarë nuk është realizuar) do të përdoret për të përpiluar Raportin vjetor për punën e shkollës fillore konkrete.

Evidenca pedagogjike për mësimin shtues të drejtuara nga mësime dhënësi klasor ose lëndor në mënyrë elektronike gjatë vitit mësimor, botohen në fund të vitit shkollor, kopja në letër regjistrohet me një numër arkivi dhe mësime dhënësi ia dorëzon drejtorit të shkollës fillore. Numri i arkivit nën të cilin certifikohet dokumenti **Evidenca pedagogjike për mësimin shtues** vendoset në **Ditarin e paraleles**, në pjesën *Evidenca për mësimin e realizuar* shtesë, nëse nxënës nga paralelja konkrete kanë marrë pjesë në mësimin shtues.

SHTOJÇË

Shembull për plotësimin e tabelës: TË DHËNA THEMELORE PËR MËSIMIN SHTUES

Lënda mësimore	Gjuhë gjermane
Numri i planifikuar i nxënësve	Sipas rezultateve të arritura dhe nevojave të përbashkëta nga mësimi shtues, numri i planifikuar i nxënësve në një grup do të jetë deri në 5.
Periodha kohore	Gjatë vitit shkollor _____, nga 1 orë në javë
Qëllimi i përgjithshëm	Plotësimi i interesave dhe nevojave të nxënësve për të zgjeruar njohuritë e tyre dhe motivimi i nxënësve për të marrë pjesë në gara, zhvillimi i një fryme konkurruese dhe interesi për gjuhët e huaja.
Rezultatet nga mësim	Njohuri, shkathtësi dhe aftësi të thelluara të fituara në fushën e gjuhës gjermane. Nxënësit janë të përgatitur për gara, shkollore, komunale, rajonale, shtetërore dhe ndërkombëtare në gjuhën gjermane. Janë zhvilluar motivet stimuluese për

	vetëvlerësimin e njohurive, aftësive dhe shkathtësive.
Mënyra e realizimit	Ushtrime mësimore gojarisht, dëgjim, lexim, shkrim, të kuptuarit. Studimi i literaturës shtuese, si dhe punimeve nga garat e mëparshme komunale, rajonale dhe shtetërore. Zbatimi i metodës së shpjegimit, puna me tekst, zgjidhja e testeve dhe analizimi i zgjidhjeve. Do të përdoret forma e punës në grupe të vogla, në çifte dhe punë individuale
Mënyra e vlerësimit	Rezultatet vlerësohen përmes suksesit të arritur në gara.
Mënyra e përdorimit të rezultateve	Shpërblimi i nxënësve për rezultatet e arritura (me notë, lavdërim). Analizë e rezultateve të arritura në mënyrë që të përmirësohet cilësia e mësimdhënies.
Mjetet/resurset e nevojshme	/